



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Kom.Dh.Shk.II.nr.992/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Clinton, Nr.5, Ndërtesa Elektro Kosova, Kati VII, kundër debitorit Pro Credit Bankë sh.a, B. H., me seli në Prishtinë, Bulevardi Dëshmorët e Kombit, për shkak të borxhit sipas dokumentit të besueshëm - ekstraktit të verifikuar nga librat afarist, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.700/22, të datës 18.05.2023, me datën 17.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.700/22, të datës 18.05.2023 VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e atakuar me ankesë, KPPP.nr.700/22, të datës 18.05.2023 e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Pro Credit Bankë sh.a, me seli në Prishtinë, dhe është anuluar urdhri përmbarimor P.nr.199/2021 i datës 01.04.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Privat Flamur Bogaj, me seli në Prishtinë, ashtu që është përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar kreditori për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit, të ndryshohet si i pabazuar aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.700/22, të datës 18.05.2023 ashtu që të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor P.nr.199/21 i datës 01.04.2021 i Përmbaruesit Privat Flamur Bogaj, apo të prishet aktvendimi i atakuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesën e debitorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me seli në Prishtinë, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.199/2021 të datës 01.04.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve të besueshme - Ekstraktit nga Librat e Afariste DPR-90002217, me të cilin është urdhëruar debitori që në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhri, të paguajë shumën prej 373.41 € në emër të borxhit kryesor me kamatë 8%, nga dita e kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive të borxhit, në llogarinë bankare të kreditorit në BKT Bankë Nr.1901682103131376, me shenjën (DPR-90002217), si dhe shpenzimet e këtij ekzekutimi në llogarinë e përgjithshme të kreditorit në BKT Bankë Nr.1901682103131182 me shenjën (Taksa e Përmbartimit DPR-90002217), në të kundërtën, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogarinë rrjedhëse, dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë bankare të kreditorit, me ndalimin e mjeteve në të ardhura personale, ose përmes regjistrimit, sekuestrimit dhe të shitjes së sendeve të luajtshme të debitorit të cilat ndodhen në posedim të tij deri në vlerën e borxhit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin e konteston në tërësi propozimin për përmbartim të kreditorit, duke theksuar se nuk njeh detyrimin që i ngarkohet. Tutje ka theksuar se është me rëndësi të ceket në propozimin dhe urdhrin për përmbartim ceket edhe një person fizik B. H., me numër personal 2010946517 që është person i panjohur për Pro Credit Bank Sh.a. Po ashtu, ka theksuar se debitori Pro Credit Bankë Sh.a ka qenë duke e shfrytëzuar me qira objektin që gjendet në Bulevardin Dëshmorët e Kombit nr.19 në Prishtinë, të cilin objekt e ka shfrytëzuar me qira deri me datën 31.05.2017 kur edhe i njëjti objekt i është dorëzuar pronarit, respektivisht përfaqësuesit të AKP-së, ku si provë është bashkangjitur dokumenti i pranim dorëzimit të objektit të nënshkruar nga të dy palët me datën 31.05.2017. Gjithashtu, debitori ka theksuar se me datën 24.05.2017 e ka njoftuar edhe kreditorin se nga data 31.05.2017 nuk do të shfrytëzoj objektin e lartcekur, dhe se të gjitha obligimet deri në ditën e pranim dorëzimit të objektit në lidhje me njehsorin DPR90002217 i bartë Pro Credit Bankë, ndërsa pas kësaj date duhet të faturohet pronari i objektit, ku si provë është bashkangjitur njoftimi i kreditorit me datën 24.05.2017 i pranuar nga kreditori në të njëjtën datë që vërtetohet me vulën e protokollimit të pranimit të tij nga ana e kreditorit, protokollin nr.5482 datë 24.05.2017. Andaj, ka propozuar që të aprovohet në tërësi si i themeltë prapësimi i debitorit, dhe të anulohet në tërësi si i pathemeltë Urdhri për Përmbartim P.nr.199/2021 i datës 01.04.2021 i Përmbartuesit Privat Flamur Bogaj, për përmbartimin e borxhit në shumën prej

373.41 €, dhe abrogohen të gjitha veprimet e ndërmarra deri më tani në këtë çështje përmbarimore.

Duke vendosur sipas prapësimit Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.700/22, të datës 18.05.2023 e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Pro Credit Bankë sh.a, me seli në Prishtinë, dhe është anuluar urdhri përmbarimor P.nr.199/2021 i datës 01.04.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Privat Flamur Bogaj, me seli në Prishtinë, ashtu që është përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbarimore. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se dokumenti i besueshëm – ekstrakti nga librat afarist nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 38 të LPP-së, ngase nuk përmban shënimet e kërkuara, gjegjësisht numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, si dhe është e paqartë se kush është palë nga ana e palës debitore, ngase në propozimin për përmbarim si palë debitori është Pro Credit Bankë sh.a Bekim Humolli, duke e bërë të pa qartë se kush është palë debitore në këtë rast, Pro Credit Bankë sh.a apo personi me emrin Bekim Humolli. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 38 i LPP, i cili përcakton se *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit - vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit”*.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë dokumenti i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbarimore, respektivisht është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative qe duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret është edhe qëndrim i kësaj gjykate se qartë

rezulton se fekstrakti i kreditorit i referohet debitorit në cilësi të saj si subjekt juridik por edhe një person tjetër fizik. Në këtë drejtim, për Gjykatën është i njohur fakti se emërtimi i konsumatorëve kryesisht evidentohet sipas njehsorit, mirëpo i takon vet kreditorit që të mirëmbajë saktë të dhënat e shfrytëzuesit të njehsorit elektrik dhe është i papranueshëm fakti se kreditori ka vazhduar ngarkesën me shpenzime për një subjekt juridik i cili nuk e ka shfrytëzuar këtë njehsor për periudhën që është objekt përmbarimi. Më tej, gjykata vlerëson se mënyra se si është evidentuar debitori me dy emra të ndryshëm që nuk paraqesin një debitor të vetëm, e bën propozimin të papërmbarueshëm. Së këndejmi, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike dhe nuk ka vepruar me shkelje të dispozitave me rastin e vendosjes si në aktvendimin e atakuar.

Rrjedhimisht, kjo gjykatë vlerëson se nisur nga fakti se procedura përmbarimore paraqet procedurë formale që i nënshtrohet shqyrtimit formal të dokumenteve përmbarimore dhe/apo atyre të besueshme, rrjedh se si kusht esencial mbi bazën e së cilës mund të lejohet përmbarimi janë tiparet e përmbarueshmërisë së dokumentit të besueshëm e të cilit në rastin konkret i mungojnë kushtet nga Neni 29 dhe 37 i LPP-së. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbarues sepse rezulton se debitori në mënyrën se si është emërtuar nuk mund të ekzaminohet qartë, duke e ngarkuar me debi një person juridik i cili nuk ka subjektivitet juridik, respektivisht duke i emërtuar dy subjekte të ndryshme në një të vetëm – me qëllim të vetëm që ta formalizohet propozimi për përmbarim. Prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve – gjë që në rastin konkret mungojnë tiparet e përmbarueshmërisë dhe gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar me rastin e vendosjes si në aktvendimin e atakuar.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.1624/22, me datë 17.10.2023

Gjyqtari
Dren Rogova